Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediaeve), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak

të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licensë profesionale** që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë:

➤ **NS12-A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

➤ **NS-14 A** Impiante te brendshme elektrike, etj.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit ISO 14001(e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.*

## **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit (2017, 2018, 2019), vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. *Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të gjermës "c", të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.*

## **2.3 Për kapacitetin teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 6 (gjashtë) persona të punësuar, të siguruar për periudhën Tetor 2020 – Dhjetor 2020, sipas profileve të mëposhtme:

- Inxhinier Mekanik, 1 person
- Inxhinier Elektrik, 1 person
- Punonjes /Specialiste për sistem ngrohje ftohje/kondicioner, 2 persona
- Elektriciste, 2 persona

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Tetor 2020 – Dhjetor 2020.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Tetor 2020 – Dhjetor 2020.

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin **inxhinier elektrik/inxhinier mekanik**, me eksperiencë punë

jo më pak se 1(një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- diplome
  - kontrata pune të vlefshme
  - librezë pune
4. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë dhe në cdo kohë, me marrjen e njoftimit, dhe me cilësinë e kërkuar për shërbim spitalor të çertifikuar, të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



## Shtojca 8

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

#### " Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve për spitalin COVID-4"

“Riparim – Mirëmbajtje e sistemeve të ngrohje – ftohjes, sistemeve të qarkullimit të ajrit, hidrantëve/fikseve të zjarrit si dhe sistemit të furnizimit me ujë në spitalin COVID-4 per nje periudhe 12 mujore, me te drejte shkeputje ne momentin e mbylljes se Spitalit Covid-4”.

Mirëmbajtja e këtyre sistemeve kërkon kontrollin e kryerjen e shërbimeve teknike dhe të riparimeve të çastit (emergjente) sipas preventivit të mësipërm.

Gjatë zbatimit riparim-mirëmbajtja punimet do të kryhen me “Urdhëra Pune“, të lëshuar nga specialistët përkatës të Sektorit Teknik të QSUNT, dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve do të hartohet process - verbali i marrjes në dorëzim ku do të nënshkruajnë të dy palët. Duhet të sigurohet gadishmëri teknike dhe shfrytëzimi 24/24 orë, me temperaturë të brendshme 20 - 22 °C.

“Urdhëri i Punës” për riparime të defekteve të çastit shoqërohet me preventiv të hartuar nga përfaqësuesi i QSUT-së dhe nënshkruhet edhe nga Operatori Okonomik, i cili merr përsipër zbatimin në afat e me cilësi të detyrave të dhëna në sipas “Urdhërit të Punës”.

Preventivi do të përmbajë njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve, çmimet merren nga oferta fituese, që është pjesë përbërëse e kontratës.

Kontrolli dhe shërbimi periodik jepen në Urdhërin e Punës nga përfaqësuesi i QSUNT-së dhe përfshin shërbimet sipas grafikut bashkëlidhur si dhe:

- Kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës, të nevojshëm për funksionimin normal të impianteve;
- Matja e parametrave te punes dhe mirëmbajtja e pompave dhe linja furnzimi me ujë, reduktor presioni ,k/valvole si dhe kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës,te nevojshem per funksionimin normal te impianteve nje here ne 20 (njëzet) ditë .

Kontrollet dhe Shërbimet që do të kryhen, janë të përshkruara në preventivin bashkëngjitur, Riparimet e çastit duhet të kryhen menjëherë, me marrjen e njoftimit.

#### **Grafiku i lëvrimit (koha e kryerjes së riparim-shërbimeve):**

- ✓ **Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara**, që jepen me “Urdhër Pune”, do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe të diela, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.
- ✓ Për rastet e **defekteve të çastit (emergjente)**, riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

**Koha e kryerjes së riparim-shërbimeve :**

- ✓ Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara, që jepen me “Urdhër Pune” do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe të diela, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.
- ✓ Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen nga e hëna deri të dielën, në çdo orë, menjëherë.
- ✓ Sistemi i aspirimit dhe trajtimit të ajrit duhet të funksionojë 24 orë/24 orë.

**Operatorët Ekonomikë, duhet të:**

- ✓ Njihen me këto sisteme dhe të deklarojnë që marrin përsipër kryerjen e këtyre riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse, në çdo orë dhe në cdo kohë, me marrjen e njoftimit, dhe me cilësinë e kërkuar për shërbim spitalor të certifikuar.
- ✓ Për të kryer shërbimet në blloqet operatore dhe reanimatore, duhet që të sigurohet temperatura e brendshme 18-20°C, ndërsa në pavionet e godinave spitalore duhet temperature 20 -22°C .

**Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuara (CE). Kohëzgjatja e kontratës, 12 muaj nga lidhja e saj me te drejte shkeputje ne momentin e mbylljes se Spitalit Covid-4.**

**Sherbimet e paraqitura ne preventive do te kryhen sipas grafikut bashkelidhur.**

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Pastrim	Kontroll	Nderrim	Larje me	Kontroll I	Kontroll I	Kontroll I
				Filtrash	vizual	filtrash	solucione	Refrigerantit	presioneve te gazit	rrymave te thithjes
				Cdo muaj	Cdo muaj	Cdo 3 muaj	Cdo 6 muaj	Cdo 6 muaj	Cdo 6 muaj	Cdo 6 muaj
1	Njesi e jashteme, sistem MINI -VRF me kapacitet Ftohes 22,4kW dhe kapacitet Ngrohes 25 kWModeli: <b>PUMY-P200YKM</b>	cope	9		X		X	X	X	X
2	Njesi e jashteme, sistem VRF me kapacitet Ftohes 22,4kW dhe kapacitet Ngrohes 25 kW. Modeli: <b>PUHY-P200YKA</b>	cope	1		X		X	X	X	X
3	Njesi e jashteme, sistem MINI -VRF me kapacitet Ftohes 15.5kW dhe kapacitet Ngrohes 16kW. Modeli: <b>PUMY-SP140YKM</b>	cope	2		X		X	X	X	X
4	Njesi e jashteme, sistem MINI -VRF me kapacitet Ftohes 15.5kW dhe kapacitet Ngrohes 16kW. Modeli: <b>PUMY-SP112VKM</b>	cope	1		X		X	X	X	X
5	Njesi e brendeshme murale, kapaciteti ftohes 5kW, dhe kapaciteti Ngrohes 5,8kW.E kompletuar me pult komandimi Wireless. Modeli: <b>MSZ-SF50VE</b>	cope	1	X	X		X			

## Dokumentat Standarde të Tenderit

6	Njesi e brendeshme murale, kapaciteti ftohes 3,5kW, dhe kapaciteti Ngrohës 4kW.E kompletuar me pult komandimi Wireless. Modeli: <b>MSZ-SF35VE</b>	cope	2	X	X		X		
7	Njesi e brendeshme murale, kapaciteti ftohes 2.5kW, dhe kapaciteti Ngrohës 3.2kW.E kompletuar me pult komandimi Wireless. Modeli: <b>MSZ-AP25VG / MSZ-SF25VE</b>	cope	60	X	X		X		
8	Njesi e brendeshme murale, kapaciteti ftohes 2,0kW (1,5kw), dhe kapaciteti Ngrohës 2,2kW(1,8kw).E kompletuar me pult komandimi Wireless. Modeli: <b>MSZ-SF20VA(MSZ-SF15VA)</b>	cope	17	X	X		X		
9	Njesi e brendeshme murale, kapaciteti ftohes 2,2kW, dhe kapaciteti Ngrohës 2,5kW. E kompletuar me pult komandimi Wireless. Modeli: <b>PKFY-P20VBM</b>	cope	4	X	X		X		
10	Njesi e brendeshme KASETE, kapaciteti ftohes 3,6kW, dhe kapaciteti Ngrohës 4kW. Modeli: <b>PLFY-P32VBM</b>	cope	9	X	X		X		
11	Njesi e brendeshme KASETE, kapaciteti ftohes 2,2kW, dhe kapaciteti Ngrohës 2,5kW. Modeli: <b>PLFY-P20VBM</b>	cope	5	X	X		X		
12	Njesi e brendeshme KANALORE, kapaciteti ftohes 7,1kW, dhe kapaciteti Ngrohës 8kW. Modeli: <b>PEFY-P63VMS</b>	cope	2	X	X		X		
13	Njesi e brendeshme KANALORE, kapaciteti ftohes 7,1kW, dhe kapaciteti Ngrohës 8kW. Modeli: <b>SEZ-M71DA</b>	cope	3	X	X		X		
14	Njesi kondicionimi murale me kapacitet ftohes 2,5kw dhe kapacitet ngrohës 3,15kw, I sherben vendit te SECURITY. Modeli: <b>MSZ-WN25VA</b>	cope	1	X	X		X	X	X
15	Pulte komandimi me fije, per hollet dhe terapin intensive <b>PAC-YT52CRA (PAR-33MAA)</b>	cope	13		X				
16	Shperndares gazi me 5 dalje <b>PAC-MK53BC</b>	cope	11		X				
17	Shperndares gazi me 3 dalje <b>PAC-MK33BC</b>	cope	10		X				
18	Njesi kondicionimi murale me kapacitet ftohes 5 kw.	cope	1	X	X		X		

## Dokumentat Standarde të Tenderit

19	Njesi ventilimi me rekuperim me eficence shkembimi termik 50-55% me sasi ventiluese ajri Q=1200m3/h @ 120Pa dhe sasi dhenese ajeri Q=1000m3/h @ 60Pa. Njesia eshte e ndertuar me profile alumini dhe llamarin xingato te termoizoluuar. Aspiratoret e njesis jane te tipit AC me 3 shpejtesi, njesia eshte e pasiru me komanden me 3 shpejtesi. Kjo njesi i sherben <b>TERAPIS INTENSIVE</b>	cope	1	X	X						X
20	Njesi ventilimi per sallën e imazheris i tipit IN-LINE Ø150 Q=400m3/h @ 50Pa, perfshire dhe komanden	cope	1		X						X
21	Njesi ventilimi per Hollin kryesor, aspirator centrifugal i futur ne kuti Q=1000m3/h @ 80Pa perfshire dhe komanden me 3 shpejtesi	cope	1		X						X
22	Njesi ventilimi per tualete modeli IN - LINE Ø100 Q=100m3/h @ 50Pa	cope	1		X						X
23	Njesi ventilimi per MAGAZINAT modeli mural Ø125 Q=150m3/h @ 25Pa i kompletuar me grile	cope	9		X						X
43	Njesi kondicionimi kasete e tipit split me kapacitet Ftohes maksimal 8.1kW dhe kapacitet Ngrohes 8.9kW. Performanca energjitike ne ftohje eshte <b>EER =3.02/</b> dhe ne ngrohje eshte <b>COP = 3.6,</b> Modeli: PEAD-SM71JAL/ SUZ-SM71VA	cope	1	X	X	X	X	X	X	X	X
44	Pulte komandimi me fije, <b>PAR-40MAA ose PAR-33MAA</b>	cope	1		X						
45	Njesi ventilimi me rekuperim me eficence shkembimi termik 50-55% me sasi ventiluese ajri Q=1500m3/h @ 80Pa dhe sasi dhenese ajeri Q=1500m3/h @ 60Pa. Njesia eshte e ndertuar me profile alumini dhe panel sanduich. Aspiratoret e njesis jane te tipit EC INVERTER me kontroll elektronik te shpejtesis. Njesia eshte e pajisur me sistem filtrimi G3+F7, Njesia eshte me 100% ajer te fresket, Njesia shoqerohet dhe me sistemin e komandimit me potenciometer frekuentativ. Njesia eshte e projektuar per instalim te jashtem ose te bredeshem Kjo njesi sherben per trajtimin e ajrit te <b>SALLES SE OPERIMIT</b>	cope	1	X	X						X

47	Sistemi i hedhjes se ajrit ne salle me HEPA 14 filter me hellje laminare te ajrit dhe me boks te prodhuar nga fabrika e prodhimit te filterit te pershtateshme per instalim ne tavan industrial 60x60, me dimensione 595x595x125 qe te flene siper struktures se gipsit.	cope	6	X	X	X				
48	Njesi e brendeshme KANALORE, kapaciteti ftohes 2.8kW, dhe kapaciteti Ngrohesh 3.2kW. Modeli: <b>PEFY-P25VMS</b>	cope	2	X	X		X	X	X	X

**Në të gjitha rastet ku referohet specifikimi teknik “CE ”, pranohen edhe "ose ekuivalent i tij / e saj".**

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

**Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve për spitalin COVID-4**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i Punimeve</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasitë e pritshme</b>
1	Pastrim filtrash njesi te jashteme dhe te brendeshme cdo muaj	Ore pune	906
2	Kontroll I permuajshem vizual i te gjithe sistemeve te kondicionimit dhe ventilimit	Ore pune	360
3	Nderrim filtrash model HEPA-14 cdo 3 muaj	Ore pune	12
4	Pastrim me solucion cdo 6 muaj	Ore pune	161
5	Kontroll I ftohesit cdo 6 muaj	Ore pune	17
6	Kontroll I presioneve të gazit cdo 6 muaj	Ore pune	26
7	Kontroll I rrymave te thithjes cdo 6 muaj	Ore pune	46
8	Filter model HEPA 14 me dimensione: 595x595x125	copë	24
9	Riparim-shërbim i pompave dhe linja furnzimi me ujë, reduktor presioni k/valvole etj.. çdo muaj	Ore pune	24
10	Rimbushje fikse zjarri me pluhur 6 kg	copë	55
11	Testim I hidranteve cdo muaj	Ore pune	72

Afatet e ekzekutimit:

Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, sipas marrëveshjes kuadër, me te drejte shkeputje ne momentin e mbylljes se Spitalit Covid-4.



## Shtojca 11

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

“Riparim – Mirëmbajtje e sistemeve të ngrohje – ftohjes, sistemeve të qarkullimit të ajrit, hidrantëve/fikseve të zjarrit si dhe sistemit të furnizimit me ujë në spitalin COVID-4 per nje periudhe 12 mujore, me te drejte shkeputje ne momentin e mbylljes se Spitalit Covid-4”.

Mirëmbajtja e këtyre sistemeve kërkon kontrollin e kryerjen e shërbimeve teknike dhe të riparimeve të çastit (emergjente) sipas preventivit të mësipërm.

Gjatë zbatimit riparim-mirëmbajtja punimet do të kryhen me “Urdhëra Pune“, të lëshuar nga specialistët përkatës të Sektorit Teknik të QSUNT, dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve do të hartohet process - verbali i marrjes në dorëzim ku do të nënshkruajnë të dy palët. Duhet të sigurohet gadishmëri teknike dhe shfrytëzimi 24/24 orë, me temperaturë të brendshme 20 - 22 °C.

“Urdhëri i Punës” për riparime të defekteve të çastit shoqërohet me preventiv të hartuar nga përfaqësuesi i QSUT-së dhe nënshkruhet edhe nga Operatori Okonomik, i cili merr përsipër zbatimin në afat e me cilësi të detyrave të dhëna në sipas “Urdhërit të Punës”.

Preventivi do të përmbajë njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve, çmimet merren nga oferta fituese, që është pjesë përbërëse e kontratës.

Kontrolli dhe shërbimi periodik jepen në Urdhërin e Punës nga përfaqësuesi i QSUNT-së dhe përfshin shërbimet sipas grafikut bashkëlidhur si dhe:

- Kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës, të nevojshëm për funksionimin normal të impianteve;
- Matja e parametrave te punes dhe mirëmbajtja e pompave dhe linja furnzimi me ujë, reduktor presioni ,k/valvole si dhe kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës,te nevojshem per funksionimin normal te impianteve nje here ne 20 (njëzet) ditë .

Kontrollet dhe Shërbimet që do të kryhen, janë të përshkruara në preventivin bashkëngjitur, Riparimet e çastit duhet të kryhen menjëherë, me marrjen e njoftimit.

**Grafiku i lëvrimit (koha e kryerjes së riparim-shërbimeve):**

- ✓ **Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara**, që jepen me “Urdhër Pune”, do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe të diela, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

- ✓ Për rastet e **defekteve të çastit (emergjente)**, riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

**Koha e kryerjes së riparim-shërbimeve :**

- ✓ Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara, që jepen me “Urdhër Pune” do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe të diela, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.
- ✓ Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen nga e hëna deri të dielën, në çdo orë, menjëherë.
- ✓ Sistemi i aspirimit dhe trajtimit të ajrit duhet të funksionojë 24 orë/24 orë.

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i Punimeve</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasitë e pritshme</b>
1	Pastrim filtrash njesi te jashteme dhe te brendeshme cdo muaj	Ore pune	906
2	Kontroll I permuajshem vizual i te gjithe sistemeve te kondicionimit dhe ventilimit	Ore pune	360
3	Nderrim filtrash model HEPA-14 cdo 3 muaj	Ore pune	12
4	Pastrim me solucion cdo 6 muaj	Ore pune	161
5	Kontroll I ftohesit cdo 6 muaj	Ore pune	17
6	Kontroll I presioneve të gazit cdo 6 muaj	Ore pune	26
7	Kontroll I rrymave te thithjes cdo 6 muaj	Ore pune	46
8	Filter model HEPA 14 me dimensione: 595x595x125	copë	24
9	Riparim-shërbim i pompave dhe linja furnzimi me ujë, reduktor presioni k/valvole etj.. çdo muaj	Ore pune	24
10	Rimbushje fikse zjarri me pluhur 6 kg	copë	55
11	Testim I hidranteve cdo muaj	Ore pune	72

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Në ambientet e Spitalit Covid 4.

## Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Me respekt  
< Emri >

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 15.

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.



- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbale të tilla që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

